



British Embassy
Pristina



Mars 2018



INDEKSI I REFORMËS SË TRANSPARENCËS KOMUNALE

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale



Raporti është përgatitur si pjesë e projektit “Promovimi i integritit social dhe pajtimit në Kosovë”, të mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe e administruar përmes Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE). Përmbajtja (apo gjetjet dhe rekomandimet) e shprehur këtu është përgjegjësi e autorëve dhe e ACDC -së dhe nuk i pasqyron qëndrimet e Ambasadës Britanike apo të OSBE-së.

Botuesi: Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)

Redaktor: Srdjan Simonovic

Kryesues i Hulumtimit: Aleksandar Djukic

Hulumtuesit: Aleksa Aleksic, Danilo Vasic

Autorë të kapitujve për komunat: Milena Ilijevaska, Jovana Jakovljevic

Dizajni dhe faqosja: Milos Kabasic

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Përmbajtja	
Hyrj	5
Komunat veriore të Kosovës.....	6
Metodologjia	7
Treguesit.....	8
Zubin Potok	12
Kryetari, Kuvendi Komunal, drejtorët.....	12
Buxheti.....	13
Qasje e lirë në informacion.....	14
Prokurimi publik, donacionet dhe kontratat.....	14
Ndërmarrjet publike dhe Administrata Publike.....	15
Raporti me Shoqërinë Civile.....	16
Planifikimi urban.....	17
Prona komunale.....	17
Mitrovicë Veriore	19
Kryetari, Kuvendi Komunal, Drejtorët.....	19
Buxheti.....	20
Qasja e lirë në informacion.....	21
Prokurimi publik, donacionet dhe kontratat.....	21
Ndërmarrjet publike dhe Administrata Publike.....	22
Raporti me Shoqërinë Civile.....	23
Planifikimi urban.....	23
Prona komunale.....	24
Leposaviq	25
Kryetari, Kuvendi Komunal, drejtorët.....	25
Buxheti.....	26
Qasja e lirë në informacion.....	27
Prokurimi publik, donacionet dhe kontratat.....	27
Ndërmarrjet publike dhe Administrata Publike.....	28
Raporti me Shoqërinë Civile.....	29
Planifikimi urban.....	29

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Prona komunale.....	30
Zveçan.....	31
Kryetari, Kuvendi Komunal, drejtorët.....	31
Buxheti.....	32
Qasje e lirë në informacion.....	33
Prokurimi publik, donacionet dhe kontratat.....	33
Ndërmarrjet publike dhe Administrata Publike.....	34
Raporti me Shoqërinë Civile.....	35
Planifikimi urban.....	35
Prona komunale.....	36

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

HYRJE

Koalicioni multisektorial i Partneritetit për Qeverisje të Hapur u formua në vitin 2011 me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel shteti, posaçërisht në nivel të qeverisjes¹.

Një pjesë e përgjegjësisë i takonte qeverive lokale rrjedhimisht u bë e nevojshme që të përmirësohet transparenca² në atë nivel gjithashtu. Çdo ditë e më shumë ka praktika të vërtetuara që kanë dalë si model për monitorim të transparencës dhe integritetit të vetëqeverisjes lokale³, si dhe zgjidhje specifike për të përmirësuar integritetin dhe transparencën në nivel të qyteteve.

Që tani mund të flasim për një bazë të lakmueshme të dhënash dhe praktikë në dispozicion të zyrtarëve publikë, politikanëve lokalë që mezi presin t'i reformojnë komunat e tyre në fushë të transparencës dhe integritetit, si dhe shoqërinë civile, dhe komunitetin akademik.

Dija dhe praktika nuk janë më problem. Integriteti i atyre që dëshirojnë të ndryshojnë dhe i atyre që kanë nevojë dhe dëshirë për ti reformuar komunat në fushën e transparencës dhe integritetit është në shqyrtim.

Minimumi që ithtarët e reformave duhet të sjellin para tyre në fushë të transparencës është: publikimi i planeve vjetore të punës së institucioneve; zhvillimi i planit për mbajtje të seancave të rregullta të kuvendeve komunale; publikimi dhe shpërndarja e materialeve dhe e akteve të miratuara nga kuvendi komunal, këshilli dhe kryetari; përfshirja e publikut dhe e qytetarëve në punën e kuvendit komunal, si dhe aktet e miratuara nga kuvendet komunale, këshilli dhe kryetari, organizimin e punës së njësive qeverisëse lokale nga administrata lokale.

Për të pasur dokument sa më të qartë, e sqarojmë në mënyrë të veçantë kuptimin e termit transparencë në këtë kuptim për lexuesin.

Me fjalën transparencë në këtë dokument, nënkuptohet mundësia që pala e interesuar (personi juridik ose fizik), bazuar në aktin normativ, apo pjesëmarrjen në proces, e ka që të marr informacione të duhura brenda një periudhe kohore në mënyrë jodiskriminuese (natyrisht, pa kosto financiare) dhe në konfidencialitet që informacionet e marra janë të rëndësishme për kah përmbajtja dhe të vërteta, kur bëhet fjalë për: Iniciativën e hartimit të aktit; hartimin e aktit; para miratimit të formës/propozimit të aktit; krijimin e formës së miratuar të aktit, duke përfshirë edhe vetë procesin e miratimit; rezultatet e zbatimit të aktit apo aktiviteteve që burojnë nga aktet e miratuara, duke përfshirë informacionet për trajtimin e aktorëve të drejtat dhe obligimet e të cilëve përcaktohen në akt.

¹ http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/attachments/leaflet_web.pdf

² Në mesin e shembujve të praktikave të mira duhet theksuar ajo e Hamburgut, Nju Jorkut, Amsterdami, Torontos, Hong Kongut, http://www.nyc.gov/html/unccp/scp/html/summit/integrity_summit.shtml; http://www.transparency.org/whatwedo/activity/strengthening_local_government_integrity

³ Metodologjia e disa organizatave nga Ballkani Perëndimor , LOTUS në Kroaci dhe lëvizja në Mal të Zi që mat transparencën e qeverive lokale.

KOMUNAT VERIORE TË KOSOVËS

Veriu i Kosovës përbëhet nga komuna me shumicë serbe përkatësisht Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Lepsaviq dhe Zubin Potok. Këto komuna kanë pasur sjellje të ndryshme nga komunat e tjera në Kosovë që nga përfundimi i konfliktit. Popullata dominuese serbe e këtyre komunave ka refuzuar çdo formë bashkëpunimi me autoritetet në Prishtinë, duke iu referuar rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, sipas së cilës tërë territori i Kosovës (Kosovë dhe Metohisë) është ligjërisht pjesë e Serbisë deri sa të arrihet një zgjidhje e plotë. Rrjedhimisht, këto komuna nuk i janë përgjigjur asnjë procesi zgjedhor të shpallur nga Qeveria e Kosovës. Me po të njëjtën sjellje, qytetarët e këtyre komunave refuzuan të merrnin pjesë në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 gjithashtu.

Zgjedhjet e fundit të organizuara nga Republika e Serbisë u mbajtën në maj 2008 dhe me gjithë kundërshtinë e shprehur përkritazi me organizimin e tyre, administrata e UNMIK-ut pranoi udhëheqësinë e zgjedhur komunale në veri dhe vazhdoi të bashkëpunonte me ta.

Marrëveshja e Brukselit krijon kushte në dukje të pranueshme për serbët që jetojnë në komunat veriore për të dalë dhe për të zgjedhur përfaqësuesit komunalë. Si rezultat i marrëveshjes së arritur ndërmjet dy palëve në Bruksel, përfaqësues të serbëve nga veriu i Kosovës filluan të regjistrojnë partitë e tyre dhe të përfshihen në fushatat parazgjedhore.

Shumica e popullatës në veri e kundërshton mbajtjen e zgjedhjeve, duke e shoqëruar me një fushatë të fuqishme për bojkotim të zgjedhjeve. Serbia i ka ftuar serbët në Kosovë të veriut të marrin pjesë për herë të parë në zgjedhjet e organizuara nga Prishtina, duke pohuar se zgjedhjet nuk e paragjykojnë statusin e Kosovës. Të hutuar dhe nën ndikimin e një fushate të fuqishme për bojkotim, shumë pak banorë të komunave veriore dolën në zgjedhje. Rrjedhimisht, dalja në Mitrovicë Veriore në orën 15 : 00 ishte 7% krahasuar me pjesën tjetër të Kosovës ku dalja ishte 32% në të njëjtën kohë të ditës. Për shkak të një incidenti të shkaktuar nga futja e ekstremistëve në disa vendvotime dhe pastaj grumbullimit të kutive me fletëvotime nga po këta ekstremistë, zgjedhjet u ndërpre në tre qendra votimi në Mitrovicë Veriore për t'u përsëritur më 17 nëntor. Sipas rezultateve të OSBE-së, dalja e votuesve në komunat e tjera veriore ishte 22% në Lepsaviq, 22 në Zubin Potok dhe 11.21% në Zveçan.

Për shkak të diskutimit rreth shenjave në deklaratat që duheshin nënshkruar kryetarët dhe kuvendarët e komunave veriore, ata e refuzuan nënshkrimin. Në janar 2014, u arrit një kompromis ku kryetarët dhe kuvendarët nënshkruan deklaratat solemne pa shenja në to, në hapësira ku gjithashtu nuk kishte shenja të vendosura. Ceremonia e nënshkrimit të deklaratave solemne në katër komuna - Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Lepsaviq u zhvillua me dyer të mbyllura.

Puna e mëtutjeshme e komunave veriore shquhet nga refuzimi i tyre për të pranuar çfarëdo lloj shenjash dalluese të statusit që ishte pjesërisht edhe arsyeja për mungesën e ueb faqeve komunale

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

zyrtare. Të përballur me trazira dhe trysni të vazhdueshme në veri, qeveritë lokale nuk kishin hapësirë të mjaftueshme për zhvillim.

Zgjedhjet lokale të organizuara në tetor 2017 karakterizohen me dalje të lartë të votuesve në zgjedhje në veri të Kosovës dhe zhvillim të qetë e pa ndonjë problem serioz.

Meqë komunat në veri të Kosovës kanë funksionuar sipas dy sistemeve, një sipas ligjeve të Kosovës, dhe tjetri sipas ligjeve të Serbisë, komunat dhe institucionet nuk ishin plotësisht funksionale, drejtoritë komunale nuk ishin themeluar, dhe nuk kishte infrastrukturë të mjaftueshme, nuk kishte personel të mjaftueshëm, s'kishte sektor të TI-së e as zyrtarë të TI-së apo të Zyrë për Marrëdhënie me Publikun, e rrjedhimisht fushëveprimi i tyre ishte i kufizuar dhe ishte vështirë të arrihej tek ndonjë informatë.

METODOLOGJIA

Me qëllim të formimit të një grupi punues për monitorimin e transparencës komunale, OJQ-ja ACDC ka përzgjedhur partnerë të njohur duke përdorur metoda të vlerësimit të përzgjedhjes që kanë përfshirë intervista paraprake me organizata nga katër komunat në veri të Kosovës, me synim zbulimin e interesit, aftësive ekzistuese dhe potencialin e tyre për zhvillim aftësitë:

Qendra Humane- Mitrovicë Veriore

Fanari- Mitrovicë Veriore

Instituti-inter për zhvillim ekonomik territorial Zubin Potok

Kosovë Veriore-Zubin Potok (ka shprehur vullnet për pjesëmarrje)

RTV Mir- Leposaviq

Miqësia- Leposaviq

Qendra e Biznesit- Zveçan

Shën Maria- Zveçan (merret ekskluzivisht vetëm me të drejta të gruas)

Organizatat e përzgjedhura morën pjesë dhe i kaluan seritë e moduleve të trajnimit që kërkohen për zbatimin e intervenimit të propozuar. Duke marrë parasysh situatën komplekse në komunat e veriut, janë përzgjedhur indikatorët për t'u monitoruar dhe metodologjia i është përshtatur rrethanave në komunat veriore

Indikatorët u ndanë në tetë fusha, të matura sipas rëndësisë ose prioritetit për përcaktimin e Indeksit të Reformës së Transparencës Komunale (në tekstin e mëtejshëm MTRI). Çdo fushë përbante një seri pyetjesh dhe vlera numerike ishte caktuar për secilën nga këto fusha, nga 1 në 5 në varësi të përgjigjeve në pyetje. MTRI është llogaritur si shuma e të gjitha vlerave numerike të marra në bazë të pyetjeve të indikatorëve.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Grupi i punues në secilën komunë ka vëzhguar drejtpërdrejt zhvillimin e vetëqeverisjes lokale, ka ndjekur mbledhjet e organeve vendimmarrëse, ka ndjekur diskutimet publike dhe fokus grupet Përveç kësaj, hulumtuesit rregullisht vëzhgonin publikimin e komunave në internet dhe postimet e reklamave të shkruara, raportet, raportet e auditimit dhe dokumentet e tjera. Përgjigjet në pyetje u grumbulluan duke vëzhguar faqen zyrtare të komunës, mediat, përmes njohurive të drejtpërdrejta, duke vizituar të gjitha qytetet në shqyrtim, duke marr informatave nga organe të tjera si Agjencia Kundër Korrupsionit, Institucioni i Avokatit të Popullit, OSHC-të, gazetarët dhe përmes bisedës me qytetarë.

Për të siguruar marrje të të dhënave nga tri burime, grupi përdori metodën e përzier si vijon:

- Qasje në dokumente publike:
- Kontakte dhe intervista të drejtpërdrejta me zyrtarë publikë, përfaqësues të opozitës, gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe sektorit privat;
- Fokus grupe me zyrtarë publikë, anëtarë të kuvendeve komunale, përfaqësues të shoqërive civile, përfaqësues të sektorit privat, gazetarë dhe palë të tjera të interesuara

Vlerësimi bazohej në qasjen në informata, përdorimin e informacionit, komunikimin e ndërsjellë dhe saktësinë e informacionit. Për çdo rezultat ka pasur një shpjegim narrativ të rrethanave në të cilat është bërë vlerësimi. Grupi Punues rezervoi të drejtën për notimin apo vlerësimin përfundimtar të indikatorëve.

ACDC dhe partnerët konkluduan se për shkak të situatës shumë komplekse, gjatë vitit të parë të monitorimit dhe zbatimit të Indeksit të Reformës së Transparencës Komunale, nuk do të ketë rezultat vlerësues të përgjithshëm për komunat, por vetëm vlerësim për secilin tregues.

TREGUESIT

Kryetari, Kuvendi Komunal, Drejtorët

- A janë publikuar biografite e kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të kompanive / institucioneve publike në faqen e internetit / media të tjera?
- A janë publikuar listat e pronave të kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të kompanive / institucioneve publike në faqen e internetit / media tjera?
- A janë kontaktet, telefonat celular/fiks dhe adresat e e-mailit në dispozicion në faqen e internetit të kryetarit ose në media tjera?
- A ka një kohë të caktuar kur kryetari i komunës takon qytetarët?
- A komunikojnë drejtorët me publikun?

Kuvendi Komunal

- A e përmban faqja e internetit listën e kuvendarëve?
- A janë vendimet e miratuara nga kuvendi komunal në dispozicion në faqe zyrtare / media të tjera?
- A janë propozimet për shqyrtim nga kuvendarët në dispozicion në faqe zyrtare / media të tjera

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

- A ka informacione për takimet e qytetarëve me kuvendarët?
- A është e publikuar agjenda për seancën e radhës së kuvendit komunal e publikuar në faqe zyrtare / media të tjera?
- A bëhet njoftimi i takimit në atë mënyrë që të arrijë deri tek zonat rurale?
- A është e mundur prania e qytetarëve në seancat e kuvendit komunal?

Buxheti

- A është veve buxheti dhe arsyetimet përkatëse në dispozicion të publikut në faqe zyrtare /media të tjera?
- A janë të publikuara planet financiare dhe përdoruesit e tërthorë të buxhetit?
- A është në dispozicion informacioni për shpenzimin tremujor të buxhetit në faqe zyrtare / media të tjera?
- A është e publikuar thirrja publike për debat mbi buxhetin të në faqe zyrtare/ media të tjera?
- A mbahen dëgjimet publike për buxhetin dhe a publikohet në faqe zyrtare / media të tjera?
- A shqyrtohet buxheti final?
- A publikohet propozimi i buxhetit të vitit të kaluar?
- A diskutohet dhe a publikohet buxheti i rishikuar

Qasja e lirë në informata

- A janë të dukshme në qendrën për shërbim (zyrën përkatëse) ose hapësirat e administratës informacionet sa i përket parashtrimin të kërkesave për qasje në informata?
- A është informacioni për parashtrimin e një kërkesë për qasje në informata në faqe të interneti?

Prokurimi publik, grantet dhe kontratat

- A gjenden në faqe /apo media të tjera informacione mbi prokurimin publik?
- A gjenden në faqe /apo media të tjera të publikuara informacione rreth prokurimit publik gjatë 12 muajve të fundit?
- A është kryer prokurimi publik në përputhje me rregulloret në fuqi?
- A gjenden në faqe /apo media të tjera informacione se si të përzgjidhet dhe të vendoset për përbërjen e komisionit vlerësues?
- A ka ndonjë manual për procedurën e tenderit dhe parimet etike të procedurës?
- A ka të dhëna për fituesin e tenderit në faqe të internetit / media të tjera?
- A janë në dispozicion të publikut kontratat me fituesit e ofertave?
- A janë publikuar në faqe të internetit raportet për ndarjen e aseteve të dhëna me qira?
- A reklamojnë dhe bëjnë thirrje rregullisht qeveritë vendore për dhënien me qira të pronës në posedim të saj?
- A gjenden në faqe të internetit/apo media të tjera të publikuara informacione për grante për media?

Ndërmarrjet publike dhe Administrata Publike

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

- A janë kriteret për përzgjedhjen e drejtorëve të kompanive publike dhe drejtuesve të departamenteve në faqe të internetit?
- A gjenden të publikuara në faqe të internetit/ media të tjera dokumente të procedurës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe udhëheqësve të departamenteve?
- A gjenden të publikuara në faqe të internetit/apo media të tjera informacione për kompanitë publike?
- A publikohen në faqe / apo media të tjera vendet e lira të punës?
- A kanë kompanitë faqe publike të internetit?
- A gjenden të publikuara në faqe / media të tjera planet e vjetore të kompanive publike?
- A gjenden në faqe të internetit/apo media të tjera informacione për sistematizimin e kompanive publike?
- A gjenden të publikuara në faqe të internetit/apo media të tjera çmimet e shërbimeve të kompanive publike?
 - A është publikuar sistematizimi i vendeve të punës dhe numri i punonjësve në faqe të internetit/ media të tjera?

Raporti me shoqërinë civile

- A i ndjekin OJQ-të takimet e Parlamentit?
- A ka memorandume të nënshkruara të bashkëpunimit me OJQ-të dhe a janë ato të publikuara në faqe të internetit /media të tjera?
- A mbahen takime konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile?
- A gjenden në faqe të internetit shpalljet e publikuara / rezultatet e konkursit për ndarje të fondeve për OJQ-të?
- A gjenden të publikuara në faqe të internetit / media të tjera raporte për zbatimin e projekteve të OJQ-ve të financuara nga komuna?

Planifikimi urban

- A gjenden në faqe të internetit / media të tjera informacione që lidhen me urbanizmin?
- A gjendet i publikuar plani hapësinor në faqe të internetit/ media të tjera?
- A janë të publikuara master-planet në faqe të internetit / media të tjera?
- A gjendet në faqe të internetit / media të tjera lista e lejeve të lëshuara për ndërtim?
- A janë të postuara në faqe të internetit /media të tjera vendimet dhe sqarimet për dhënien e lejeve për ndërtim?
- A ka komuna hartë interaktive në internet?
- A ka komuna plan të publikuar për mbrojtje të mjedisit dhe menaxhim të burimeve natyrore në faqe të internetit /media tjera.
- A gjenden në faqe të internetit / media të tjera informacione se lejet e ndërtimit janë lëshuar në përputhje me planin urban?

Prona komunale

- A mban administrata regjistër me të dhëna për pronën në posedim të komunës dhe a gjendet kjo

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

në faqe të internetit / media të tjera?

- A ka hartë interaktive me të dhëna për pronat në pronësi të komunës?

- A gjenden në faqe të internetit / media tjera informacione lidhur me qiradhënien apo shfrytëzimin e pasurisë komunale?

- A gjendet në faqe të internetit / media të tjera vendimet për transferin e pronës komunale në pronë private?


- A ka komuna listë të inventarit dhe a është kjo e publikuar në faqe/media tjera?

- A ka një listë të automjeteve zyrtare dhe vlerës së tyre dhe a është kjo e publikuar në faqe të internetit / media tjera?

- A ka të dhëna për aksionet e komunës në kompani tjera dhe a gjenden këto në faqe të internetit / media tjera?

ZUBIN POTOKU

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale



KRYETARI, KUVENDI I KOMUNËS, DREJTORËT

Komuna e Zubin Potokut e ka një faqe zyrtare të internetit që megjithatë nuk është funksionale dhe si pasojë shumë informata nuk janë në dispozicion për qytetarët. Prandaj biografitë dhe informatat e kontaktit (numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike) të kryetarit dhe drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve nuk mund të gjenden në ndonjë mjet informimi. Koha kur kryetari takohet me qytetarë është e përcaktuar dhe është çdo të premtë, Gjithashtu, qytetarët e komunës së Zubin Potokut kanë mundësi të komunikojnë edhe me drejtorët e kompanive publike ose të institucioneve përmes kontaktit të drejtpërdrejtë ose përmes shkuarjes në kompani apo institucion. Numrat e telefonave zyrtar të kryetarëve, drejtorëve të kompanive publike janë në dispozicion të qytetarëve, por në to zakonisht përgjigjen sekretaret. Numrat telefonik të anëtarëve të kuvendeve komunale nuk janë në dispozicion. Listat e pasurisë së kryetarit dhe drejtorëve të ndërmarrjeve publike/institucioneve janë publikuar vetëm në ueb faqen e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Në lidhje me punën e kuvendit dhe anëtarëve të tij, lista e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Zubin Potokut ekziston vetëm në ueb faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndërsa propozimet për shqyrtim në kuvend dhe vendimet e kuvendit shpallen në tabelën e shpalljeve të Komunës për disa ditë me radhë. Ndonëse qytetarëve u mundësohet pjesëmarrja në seancat e

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Kuvendit, numri i atyre që marrin pjesë është shumë i vogël për shkak të shpërfilljes së kësaj të drejte, si pasojë e mungesës së ndërgjegjësimit. Në të vërtetë, njoftimet për mbajtjen e seancës së kuvendit, si dhe agjenda, u shpërndahen anëtarëve të kuvendit në postën elektronike private, si dhe organizatave që rregullisht monitorojnë mbledhjet e kuvendit komunal siç janë UNMIK-u, OSBE-ja, LMT-ja dhe organizatat e shoqërisë civile që kanë shprehur interes në monitorimin e seancave të kuvendit. Njoftimet gjithashtu shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në mediat lokale, kështu që informacioni për mbledhjen e kuvendit arrin edhe tek ata që jetojnë në zonat rurale.

Kryetari i komunës, drejtorët dhe anëtarët e kuvendit përgjigjen rregullisht dhe marrin pjesë në debatet publike të organizatave të shoqërisë civile.

Konstatim: Transparenca e punës së kryetarit, drejtorëve dhe anëtarëve të kuvendit është në nivel të kënaqshëm. Procesi i vendimmarrjes në kuvendin komunal është i hapur për qytetarët dhe organizatat.

Rekomandime: Të vazhdohet me praktikën e ditës së hapur për pritjen e qytetarëve nga kryetari i komunës. Të themelohet mekanizmi për kontakt të drejtpërdrejtë të qytetarëve me përfaqësuesit e kuvendit dhe drejtorët e ndërmarrjeve publike

INDEKSI: 3.2 Mirë

BUXHETI

Propozim buxheti dhe shpjegimi i tij nuk mund të gjendeshin në faqen e internetit të komunës sepse nuk kishte një të tillë. Një rrethanë tjetër që e bën buxhetin interesant është se buxheti nuk përcaktohet në komunë sipas propozimit dhe prioriteteve, por shuma përfundimtare merret nga Ministria e Financave, e përcaktuar në mënyrë të sheshtë me shpjegimin që, siç deklarojnë autoritetet lokale, në veri nuk është kryer regjistrimi i popullsisë, prandaj është përcaktuar buxheti i bazuar në vlerësimin e përafërt.

Shuma e buxhetit të pranuar nga qeveria në Prishtinë botohet në mediat lokale por jo edhe shpërndarja e saj.

Propozimi për llogarinë përfundimtare për vitin paraprak u paraqit si pikë e rendit të ditës në seancën e kuvendit dhe u diskutua pas kësaj. Për vitin 2018 është mbajtur debat publik për buxhetin për të cilin u bë njoftim në mediat lokale, por pjesëmarrja e qytetarëve në diskutim ishte e padukshme. Rishikimi i buxhetit po ashtu u propozua si pikë e rendit të ditës në seancën e Kuvendit Komunal të Zubin Potokut, por nuk pati shumë debat rreth tij për shkak të pjesëmarrjes së ulët të qytetarëve. Për shkak të mosfunksionimit të ueb faqes zyrtare të komunës së Zubin Potokut, buxheti, planet financiare të përfituesve të tërthortë, informatat për zbatimin tremujor të

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

buxhetit, njoftimet për diskutim publik për buxhetin dhe informatat e ngjashme në lidhje me buxhetin e komunës së Zubin Potokut, janë të publikuara vetëm në tabelën e shpalljeve të komunës për disa ditë me radhë, por sipas përfaqësuesve të sektorit civil, informacionet mund të sigurohen me kërkesë.

Konstatim: Shuma e buxhetit është e njohur për qytetarët dhe palët e interesuara, diskutimet buxhetore janë publike dhe, në këtë drejtim, ky indikator vlerësohet pozitivisht. Kur flitet për informacionet që kanë të bëjnë me raportimin e shpenzimeve buxhetore, konkludimi është se ato janë gjysmë të publikuara në mediat lokale dhe se transparenca rreth shpenzimeve nuk është në nivel të kënaqshëm.

Rekomandime: Aktivizimi i faqes zyrtare të komunës ose gjetja e mundësive tjera për të siguruar informacione në përputhje me ligjin; shtimi i thirrjeve drejtuar mediave lokale për të raportuar mbi temën e këtij indikator.

INDEKSI 2.6 I kënaqshëm

QASJA E LIRË NË INFORMACION

Informatat ose njoftimet për mënyrën e paraqitjes së kërkesës për qasje në dokumente publike nuk ekzistojnë në ndërtesën e komunës. Informatat për mënyrën e paraqitjes së kërkesës ose për marrje të informacionit mund të merret me kërkesë në zyrën pritëse në ndërtesën komunale. Meqë faqja e internetit e komunës së Zubin Potokut nuk është funksionale, për këtë arsye nuk ka të dhëna për paraqitjen e kërkesave për qasje në informata.

Konstatim: Vetëdijesim mjaft i ulët përkitazi me qasjen e lirë në informata. Është vërejtur dyshim i shfaqur nga recepcionisti gjatë kontrollit të mundësisë për të siguruar informata të rëndësishme publike. Paqartësi rreth asaj se cilat informata janë të rëndësishme publike.

Rekomandime: Vendosja e udhëzimeve për kërkim të informatave për dokumente të interesit publik në vende të dukshme. Është i dëshirueshëm edukimi i punonjësve për këtë çështje si dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën e qasjes në informata.

INDEKSI: 2.6 I kënaqshëm

PROKURIMI PUBLIK, DONACIONET DHE KONTRATAT

Për shkak të mosfunksionimit të ueb faqes zyrtare të komunës, informatat për prokurimin publik publikohen në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e komunës për disa ditë me radhë. Të dhënat e prokurimit publik për 12 muajt e fundit gjithashtu publikohen edhe në tabelën e shpalljeve.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Burimet që janë përdorur për këtë hulumtim pretendojnë që prokurimi publik zbatohet në përputhje me rregulloret e zbatueshme.

Në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ku të gjitha prokurimet publike publikohen në Kosovë, të dhënat mund të merren vetëm me regjistrim paraprak dhe janë të plota dhe gjithëpërfshirëse kur bëhet fjalë për këtë komunë.

Nuk ka informata për mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit të vlerësimit dhe mënyrën në të cilën komisioni vendos për fituesin e tenderit pavarësisht nga ekzistenca e udhëzimeve për procedurat e tenderit dhe parimet etike të vetë procedurës. Informatat për fituesin e tenderit publikohen në tabelën e njoftimit dhe kontratat me fituesit e tenderit mund ti vihen në dispozicion qytetarëve vetëm në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Nuk ka informata në dispozicion për dhënien me qira të pronës komunale, ose për ndonjë thirrje publike për dhënien me qira të pronës komunale. Sipas fjalëve të zyrtarëve komunal, komuna nuk posedon prona.

Për shkak të buxhetit të kufizuar të komunës së Zubin Potokut nuk ka fonde për të mbështetur punën e mediave.

Konstatim: Procesi i prokurimit publik është mjaft transparent krahasuar me komunat e tjera, por jo në nivel të kënaqshëm; Shihet vullnet i dukshëm në mesin e zyrtarëve të qeverisë lokale për të përmirësuar transparencën në këtë pjesë.

Rekomandime: Duke pasur parasysh se ky tregues është vërejtur veçanërisht në luftën kundër korrupsionit, rekomandimet për autoritetet lokale janë se për shkak të mungesës së faqeve zyrtare, informatat vijuese duhet të publikohen në tabelën e shpalljeve: të gjitha të dhënat në lidhje me komisionin e vlerësimit, të gjitha të dhënat mbi fituesit e tenderit, të gjitha kontratat me fituesit e tenderit, të dhënat mbi dhënien me qira të pronës komunale dhe kontratat e qirasë. Rekomandimi është që ky informacion të jetë në tabelën e shpalljeve deri në kohën kur pjesa e faqes zyrtare të internetit të komunës së Zubin Potokut të jetë funksionale dhe në çdo rast jo më pak se një vit nga data e publikimit.

INDEKSI: 2.8 i kënaqshëm

NDËRMARRJET PUBLIKE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE

Ekzistojnë kritere për përzgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe drejtorëve të drejtorive, por dokumentet në lidhje me procedurat e përzgjedhjes së drejtorit dhe drejtorit të drejtorisë janë të publikuara vetëm në tabelën e shpalljeve. Ndërmarrjet publike në komunën e Zubin Potokut nuk kanë ueb faqet e tyre, prandaj edhe nuk publikohen planet vjetore të punës e as raportet për punën e tyre. Informata e tillë është në dispozicion në bazë të kërkesës për qasje në

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

dokumente publike, ndërsa në shumicën e rasteve lista e çmimeve për ndërmarrjet e shërbimeve publike publikohet në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjeve përkatëse. Drejtorët nuk janë zgjedhur ende në këtë komunë.

Nuk janë publikuar askund sistematizimi i ndërmarrjeve publike si dhe sistematizimi i vendeve të punës dhe numrit të punëtorëve, por janë në dispozicion me kërkesën e parashtruar për qasje në dokumentet publike.

Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve për punësim në ndërmarrjet komunale deri tani kanë qenë të paqasshme për publikun, por duhet të merret parasysh se në këtë komunë ende nuk ka pasur vende të lira pune.

Konstatim: Ka shumë hapësirë për përmirësim në aspektin e punës transparente. Plani vjetor i punës dhe raportet mbi punën e kompanive dhe organeve komunale janë jo-mjaftueshëm transparente. Përbërja e komisionit dhe mënyra e vlerësimit për punësim është e panjohur.

Rekomandime: Të publikohen planet vjetore të punës në media dhe në tabelat e shpalljeve. Të publikohet në tabelën e shpalljeve metoda e vlerësimit dhe përbërja e komisionit kur të përcaktohen kriteret për kandidatin sapo të shpallen vendet e lira të punës.

INDEKSI 2.8 i kënaqshëm

RAPORTET ME SHOQËRINË CIVILE

Komuna e Zubin Potokut ka marrëdhënie me shoqërinë civile në nivel të lakmueshëm. Seancat e Kuvendit janë të hapura për organizatat e shoqërisë civile dhe përveç kësaj, organizatat që rregullisht monitorojnë seancat e Kuvendit informohen rregullisht për seancat. Komuna e Zubin Potokut ka nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me OJQ dhe organizata të tjera të shoqërisë civile jo vetëm nga territori i komunës por edhe nga vendet e tjera. Këto memorandume nuk publikohen në media, përveç në faqet e internetit të disa organizatave që kanë memorandume, mirëpo me kërkesën për qasje në dokumente publike, ato janë në dispozicion për inspektim. Takimet me përfaqësuesit e shoqërisë civile mbahen sipas nevojës, por sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile ato mund të caktohen lehtësisht. Sidoqoftë, komuna e Zubin Potokut nuk ka fonde të mjaftueshme për të financuar sektorin e OJQ-ve përveç nëse komuna dhe OJQ-të zbatojnë ndonjë projekt të përbashkët. Në këtë rast, duke qenë se ueb faqja zyrtare e komunës së Zubin Potokut nuk është në funksion, të gjitha informatat që kanë të bëjnë me zbatimin e projekteve mund të gjenden në tabelën e shpalljeve faqet e internetit të organizatave, rrjetet sociale të këtyre OJQ-ve dhe / apo në ueb faqet e mediave elektronike (KoSSev, Radio Mitrovica Sever, etj.).

Konstatim: Duke pasur parasysh se komuna e Zubin Potokut nuk ka mjete financiare për të përkrahur organizatat e shoqërisë civile, është shumë i kënaqshëm raporti që ka në kuptim të

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

ofrimit të çfarëdo përkrahjeje tjetër. Ka hapësirë për përmirësimin e transparencës së punës me organizatat e shoqërisë civile.

Rekomandime: Pas çdo memorandumi të mirëkuptimit apo letre përkrahëse, të publikohen shpalljet në media deri në publikimin përfundimtar në ueb faqe dhe më pas të gjitha informatat të publikohen në ueb faqe.

INDEKSI 3.8 Mirë

PLANIFIKIMI URBAN

Në mungesë të një uebfaqeje zyrtare komunale, të gjitha informatat në lidhje me planifikimin urban - planet hapësinore, planet urbanistike, lista e lejeve të lëshuara të ndërtimit, vendimet dhe sqarimet për lëshimin e lejeve të ndërtimit, si dhe informatat nëse lejet e lëshuara të ndërtimit janë në përputhje me planin urban, etj, janë në dispozicion përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike.

Siç është thënë në komunë, është duke u përgatitur harta interaktive e komunës së Zubin Potokut. Komuna nuk ka plan për mbrojtjen e mjedisit, por është planifikuar dizajni i tij.

Konstatim: Transparenca shumë e ulët e këtij treguesi, duke marrë parasysh rëndësinë dhe pozitën e Zubin Potokut si një komunë me burimin e vetëm serioz të ujit dhe potencial të madh për zhvillimin e turizmit.

Rekomandime: Të publikojë të gjitha lejet e ndërtimit të lëshuara në tabelën e buletinit në mungesë të mjeteve elektronike të informimit. Të aplikojë për financim për zhvillimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis me agjencitë kompetente dhe të fillojë hartimin e planit me anë të angazhimit transparent të ekspertëve më të shquar vendor. Të përfundoj hartën interaktive.

INDEKSI 2.6 I kënaqshëm

PRONA KOMUNALE

Sipas zyrtarëve komunal, nuk ka regjistër publik të pronës komunale sepse Komuna e Zubin Potokut, e cila funksionon sipas ligjeve dhe sistemit të Kosovës, nuk ka prona në posedim të saj. Nuk ekziston hartë interaktive me informata për pronën komunale si dhe nuk ka informata për shfrytëzimin e pronës komunale. Prandaj, prona komunale nuk mund të ndryshohet dhe të jetë në pronësi private, as me qira. Gjithashtu edhe më herët nuk ka ndodhur që prona komunale të privatizohet.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Në fund të çdo viti, përpilohet një listë e inventarit që publikohet në tabelën e njoftimeve për disa ditë më radhë. Përveç kësaj, lista e inventarit është në dispozicion për shqyrtim në bazë të kërkesës për qasje në dokumentet publike. Komuna e Zubin Potokut nuk ka aksione në kompani të tjera, dhe prona në pronësi të kompanive komunale është plotësisht në dispozicion të këtyre kompanive. Listat e automjeteve në pronësi të komunës dhe vlera e tyre nuk është e publikuar gjëkund.

Konstatim: Situata është shumë e paqartë pasi që është e ditur se komuna ka disa prona duke filluar nga ndërtesat, automjetet dhe mobilet. Megjithatë, në sistemin e Kosovës këto objekte nuk janë regjistruar si pronë e komunës.

Rekomandime: Të zhvilloj hartën interaktive për pronën komunale, për të bërë një listë të automjeteve komunale dhe vlerat e tyre dhe të vendoset në tabelën e shpalljeve derisa uebfaqja komunale të bëhet funksionale.

INDEKSI 2.8 I kënaqshëm

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Mitrovica e Veriut

Raport për Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale



KRYETARI, KUVENDI KOMUNAL, DREJTORËT

Komuna e Mitrovicës së Veriut nuk ka uebfaqe zyrtare, sipas shpjegimit të punonjësit komunal, ajo hoq nga qeveria qendrore në Prishtinë, kështu që nuk është e mundur të merren të dhëna të tilla si biografite dhe kontaktet e kryetarëve të komunave dhe funksioneve tjera publike. Informatat e vetme në dispozicion për kryetarin dhe drejtorët e kompanive publike janë ato që janë theksuar në kartat e pronësisë të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në komunën e Mitrovicës së Veriut ekziston praktika e caktimit të kushteve në të cilat kryetari i komunës i pranon qytetarët nga ora 08-16. Drejtorët e kompanive publike nuk kanë planifikuar kohë për t'u takuar me qytetarët.

Vlen të përmendet se komuna e Mitrovicës së Veriut ka zyrë administrative të udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut, sipas sistemit juridik të Kosovës, ka 19 këshilltarë dhe pas procesit zgjedhor, lista e të gjithë këshilltarëve është publikuar në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe lista e këshilltarëve është publikuar në një numër të

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

mediave lokale. Seancat e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut janë, në shumicën e rasteve, të hapura për publikun, dhe publikohen përmes mediave, ku publikohet edhe rendi i ditës dhe pikat e rendit të ditës. Kjo mënyrë e informimit për mbajtjen e seancës së Kuvendit nuk ka problem të arrijë tek të gjithë qytetarët e interesuar, duke marrë parasysh se në zonën e Mitrovicës së Veriut nuk ka shumë zona rurale. Burimet e informacionit janë kryesisht disa radio stacione komerciale lokale pa program informativ.

Vendimet e miratuara nga Kuvendi në përgjithësi mund të dëgjohen duke marrë pjesë në mbledhje ose duke lexuar në portalet e mediave lokale, në varësi të aktualitetit dhe rëndësisë së vendimeve të miratuara. Nuk ka asnjë vazhdimësi për sa i përket njoftimeve nga një vend, kryesisht për shkak të mungesës së një faqeje zyrtare të komunës. Gjithashtu, nuk ka të dhëna nëse dhe deri në çfarë mase qytetarët u drejtohen këshilltarëve për zgjidhjen e problemeve të caktuara ose paraqesin disa sugjerime me rëndësi për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të kësaj komune.

Konstatim: Transparenca e punës së Kryetarit, Kryeshefit Ekzekutiv, drejtorëve dhe anëtarëve të Kuvendit në nivel të kënaqshëm. Procesi i vendimmarrjes në kuvendin komunal është i hapur për qytetarët dhe organizatat.

Rekomandime: Rritja e bashkëpunimit me media dhe promovimi i krijimit të faqes komunale të internetit, si dhe informimi i qytetarëve për punën e komunave përmes rrjetit të mediave sociale.

INDEKSI: 2.8 I kënaqshëm

BUXHETI

Komuna e Mitrovicës së Veriut respekton afatet për miratimin e buxhetit vjetor. Pas miratimit, buxheti publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave të Kosovës. Raporti i Kuvendit për miratimin e buxhetit për vitin 2018 është në dispozicion në mediat lokale. Raportet tremujore mbi ekzekutimin e buxhetit si për vitin aktual ashtu edhe ato të mëparshme janë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Financave të Kosovës. Mirëpo në të njëjtën faqe është lënë jashtë publikimi i planeve financiare të përdoruesve të tërthortë të buxhetit. Në komunën e Mitrovicës së Veriut janë planifikuar seanca publike për buxhetet ku për vitin 2018 është mbajtur në shtator dhe raporti nga seanca e Kuvendit është publikuar në media. Buxheti final për vitin paraparak u diskutua publikisht dhe raporti u publikua në media. Në komunën e Mitrovicës së Veriut, situata është e njëjtë edhe kur bëhet fjalë për ribalancimin e buxhetit, i cili u diskutua publikisht dhe u shfaq përmes disa mediave (TV Most, Mreza).

Konstatim: Shkalla e transparencës së këtij treguesi kompleks është në nivel të kënaqshëm, përkundër faktit të mungesës së faqes së internetit në komunë. Është vlerësuar pozitivisht informacioni i dhënë me kohë organizatave të shoqërisë civile për seancat e Kuvendit për buxhet dhe fakti që raporti nga seanca publike për buxhet është publikuar në media.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Rekomandime: Të publikohen në media planet financiare të përfituesve të tërthortë dhe informatat për zbatimin tremujor të buxhetit. Të nisët fushatë për shtimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në diskutimet për buxhet. Të arkivohen të dhënat në mënyrë që të ngarkohen menjëherë në faqe pasi që të jetë krijuar.

INDEKSI 2.8 I kënaqshëm

QASJA E LIRË NË INFORMACION

Në komunën e Mitrovicës së Veriut, ashtu si në shumicën e komunave të Kosovës, ekziston një sasi e caktuar e jo-transparencës dhe mungesë e disponueshmërisë kur bëhet fjalë për informacion me interes publik. Megjithatë, në komunën e Mitrovicës së Veriut nuk ka procedurë për marrjen e dokumenteve publike. Kur qytetarët e komunës së Mitrovicës së Veriut kanë nevojë për disa të dhëna që nuk janë të publikuara në mediat në dispozicion të tyre, mënyra më e lehtë për ta bërë këtë është përmes adresimit të emailit tek Kryeshefi Ekzekutiv. Qytetarët, megjithatë, nuk dinë se si t'i qasen këtij procesi, sepse informacioni rreth paraqitjes së kërkesave për qasje në informata nuk është i dukshëm në qendrën e shërbimeve ose në objektin e Bordit Drejtues. Rrjedhimisht, nuk ka të dhëna për kërkesat e paraqitura tashmë për qasje në informata.

Konstatim: Ekziston një praktikë që qytetarët dhe OShC-të kërkojnë qasje në dokumente publike drejtpërdrejtë nga kryeshefi ekzekutiv që mund të jetë praktikë e mirë në rrethanat ekzistuese, por fakti është se nuk ka asnjë procedurë zyrtare apo udhëzime se si të paraqitet kërkesa.

Rekomandime: Të vendosen në një vend të dukshëm udhëzimet për të kërkuar qasje në dokumente publike. Është i dëshirueshëm edukimi i punonjësve për këtë çështje si dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën e qasjes në informata.

INDEKSI: 2.8 I kënaqshëm

PROKURIMI PUBLIK, DONACIONET DHE KONTRATAT

Në Kosovë ekziston Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, i cili publikon të gjitha prokurimet publike për tërë territorin e Kosovës. Meqenëse komuna e Mitrovicës së Veriut nuk e ka faqen zyrtare të internetit, të dhënat mund të gjenden vetëm në këtë portal me regjistrim paraprak të përdoruesve. Në këtë portal, informacioni mund të gjendet edhe në lidhje me prokurimin publik për periudhat e mëparshme dhe jo vetëm për vitin aktual. Gjithashtu, në këtë portal ka edhe një udhëzim që i referohet procedurave të tenderit dhe parimeve etike të vetë procedurës.

Në komunën e Mitrovicës së Veriut, prokurimet publike bëhen në pajtim me rregulloret në fuqi. Të dhënat mbi fituesit e tenderit duhet të jenë në dispozicion në portalin e Komisionit Rregullativ

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

të Prokurimit Publik. Është e dukshme që në këtë portal dhe në mënyrat tjera të informacionit nuk ka informata se si përzgjidhen anëtarët dhe si vendoset për përbërjen e komisionit vlerësues por praktika është që anëtarët e komisionit të emërohen pak para seancës për të shmangur presionin e mundshëm. Komuna e Mitrovicës së Veriut nuk posedon pronë kështu që kontrata për dhënie me qira të pronës nuk ekziston. Komuna e Mitrovicës së Veriut nuk ka mjete për mbështetjen e mediave.

Konstatim: Transparenca e këtij treguesi është bazuar në informacionin që njerëzit mund ta marrin nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe përshtypja është se qytetarët nuk ishin të informuar mirë për tenderët dhe kontratat.

Rekomandime: Në mungesë të një ueb faqeje komunale funksionale, të përdoren mediat për të shpallur metodën e përzgjedhjes së komisionit për vlerësimin e dokumenteve të tenderit, si dhe në përgjithësi të përdoren mediat për të informuar qytetarët për prokurimin publik, donacionet dhe kontratat.

INDEKSI 2.6 I kënaqshëm

NDËRMARRJET PUBLIKE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE

Komuna e Mitrovicës së Veriut ende nuk i ka të gjitha 14 departamentet e përcaktuara me Statut. Tani për tani, ka vetëm 7 drejtori funksionale me shefat e tyre. Administrata është trashëguar nga Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut që i ka emëruar ato në përputhje me kriteret e vlefshme të asaj kohe. Kur bëhet fjalë për raportet mbi punën e ndërmarrjeve publike, komuna e Mitrovicës nuk e bën publikimin e tyre për shkak të situatës specifike dhe sistemin e dyfishtë që ka ekzistuar deri kohet e fundit.

Njësia e vetëqeverisjes lokale Mitrovica e Veriut u krijua pas Marrëveshjes së Brukselit dhe ende ka nevojë për rekrutimin e stafit të ri. Vetëqeverisja lokale i shpalli vendet e lira të punës në disa media dhe në tabelat e shpalljeve në zyrat e Administratës Komunale të Mitrovicës së Veriut.

Kompanitë publike që veprojnë në këtë komunë ballafaqohen me probleme të shumta dhe nuk ndjekin inovacionet në biznes, kështu që nuk kanë faqe interneti aktive. Gjithashtu, nuk publikohen as planet e tyre vjetore të punës, as ndryshimet që ndodhin në strukturat e tyre organizative në lidhje me klasifikimin e vendeve të punës. Në lidhje me listën e çmimeve të shërbimeve të ndërmarrjeve publike, informacioni është e mundur të merret ekskluzivisht me vizitë të drejtpërdrejtë në kompaninë ku listat e çmimeve janë vendosur në tabelat e shpalljeve dhe duke parashtruar pyetje me shkrim në lidhje me listën e çmimeve.

Konstatim: Duke marrë parasysh ngjarjet e fundit politike dhe integrimin në sistemin e Kosovës, do ta vlerësojmë këtë tregues si të kënaqshëm, pavarësisht transparencës jo të mjaftueshme të planeve vjetore të punës dhe raporteve mbi punën e kompanive dhe organeve komunale.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Karakteristikë është edhe dështimi për të publikuar planet vjetore të punës së ndërmartjeve si dhe mos-zbulimi i listës së çmimeve të shërbimeve.

Rekomandime: Të publikohen planet vjetore të punës në media dhe në tabelat e shpalljeve. Të publikohet në tabelën e shpalljeve metoda e vlerësimit dhe përbërja e komisionit kur të përcaktohen kriteret për kandidatin. Të krijohen faqet e internetit të kompanive publike.

INDEKSI 2.6 I kënaqshëm

RAPORTET ME SHOQËRINË CIVILE

Duke pasur parasysh se ekziston numër i madh i OJQ-ve aktive në komunën e Mitrovicës së Veriut, shpesh ndodh që përfaqësuesit e tyre të jenë prezent dhe ndjekin seancat e Kuvendit. Disa OJQ kanë nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me vetëqeverisjet lokale dhe informatat mund të gjenden në faqet zyrtare të internetit ose në ato të Fejsbukut të OJQ-ve, por jo edhe teksti i memorandumit të bashkëpunimit. Bashkëpunimi i qeverisë lokale të Mitrovicës së Veriut me OJQ-të është në nivel të lartë. Një iniciativë që u ndërmor gjithashtu nga vetëqeverisja lokale ishte zhvillimi i takimit të përbashkët me përfaqësuesit e OJQ-ve për të diskutuar bashkëpunimin e tyre në të ardhmen. Në mediat lokale, është e mundur të gjejmë njoftime që vetëqeverisja lokale bënë thirrje për ndarjen e fondeve për OJQ-të. Rezultatet e konkursit publikohen në media dhe komunikohen drejtpërdrejt me OJQ-të. Informatat mbi projektet e financuara nga qeveritë lokale publikohen nga OJQ-të, në media si dhe në faqet e tyre zyrtare, në veçanti duke promovuar rezultate të mira.

Konstatim: Marrëdhënia që komuna e Mitrovicës së Veriut e ka me organizatat e shoqërisë civile dhe transparenca e këtyre marrëdhënieve është në nivel të kënaqshëm. Transparenca në ndarjen e fondeve për OJQ-të dhe sigurimi i çdo mbështetjeje tjetër është në nivel shumë të kënaqshëm.

Rekomandime: Pas çdo memorandumit të mirëkuptimit apo letrave përkrahëse, t'i drejtohen mediave me ato deri në publikimin në ueb faqe dhe më pas të gjitha informatat të publikohen në ueb faqe.

INDEKSI 3.2 Mirë

PLANIFIKIMI URBAN

Planifikimi urban është pjesë integrale e punës së çdo qeverie lokale. Në komunën e Mitrovicës së Veriut njoftimet bëhen vetëm për ndërtimin e disa objekteve më të mëdha dhe organizimin e zonave urbane. Sa i përket planeve hapësinore, ato ekzistojnë nga periudha e mëparshme, por plani i ri hapësinor dhe plani urbanistik janë në proces të zhvillimit.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Si si në komunitet e tjera në veri të Kosovës, ashtu edhe në Mitrovicën e Veriut ekziston një problem i dhënies së lejeve të ndërtimit që po tejkalohet nëpërmjet bashkëpunimit me ministrinë përkatëse. Për momentin janë gjetur modalitete të ndryshme për lëshimin e tyre, kështu që nuk ka informata në lidhje me vendimet për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Edhe pse jetojmë në një epokë informacioni dhe teknologjie bashkëkohore, komuna e Mitrovicës së Veriut nuk ka zhvilluar hartë interaktive online, e cila mund të përdoret nga një numër i madh qytetarësh.

Konstatim: Mungesa e planeve hapësinore sigurisht që është problem për një qytet ku praktika, për shkak të gjendjes së njohur politike e të sigurisë, ngritja e ndërtesave pa leje ndërtimi është problem me të cilin do të ballafaqohet ky pushtet si dhe çdo pushtet tjetër në të ardhmen. E njëjta vlen edhe për planin urbanistik.

Rekomandime: Të publikojë planet hapësinore dhe urbane në mediat publike kur ato janë në dispozicion për publikun. Të publikohet lista e lejeve të ndërtimit në media lokale.

INDEKSI 2.5 Neutral

PRONA KOMUNALE

Ekziston një problem i madh i pronësisë mbi pronën në komunën e Mitrovicës së Veriut. Vetëm komuna ka informacion në lidhje me pronësinë e saj, megjithëse këto të dhëna nuk janë publikuar askund dhe nuk është krijuar harta interaktive me të dhënat mbi pronësinë komunale. Kur është fjala për marrjen me qira dhe shfrytëzimin e pronës komunale, komuna e Mitrovicës nuk e ndan këtë informacion me publikun nëpërmjet mjeteve zyrtare të informimit. Vendimet për transferimin e pronës së komunës, si dhe lista e inventarit, nuk janë shpallur nga komuna. Disa informacione në lidhje me këtë, si lista e automjeteve zyrtare mund të gjenden në raportet e auditimit të publikuara në fund të çdo viti. Informatat rreth asaj nëse një komunë zotëron aksione në kompani tjera nuk janë në dispozicion në media.

Për shkak të arsimimit joadekuat të nëpunësve komunal, komuna ka shënuar pronën e saj me bar-kode dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike ka punuar në vendosjen e këtij informacioni në faqen e internetit të Agjencisë Kosovare të Pronës (E-Pronës).

Konstatim: Nivel i dobët i transparencës së të dhënave rreth pronës komunale.


Rekomandime: Të krijohet harta interaktive dhe regjistri i pronës publike në pronësi të komunës dhe ta publikohet në media, dhe të publikohen ato pas lansimit përfundimtar të faqes zyrtare të komunës së Mitrovicës Veriore. Të publikohet lista e automjeteve në pronësi komunale dhe shuma e vlerës së tyre.

INDEKSI: 2.5 Neutral

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

LEPOSAVIQI

Raport për Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale



KRYETARI, KUVENDI KOMUNAL, DREJTORËT

Komuna e Leposaviqit nuk ka faqe funksionale zyrtare, gjë që rezulton në faktin se shumë informata nuk janë në dispozicion të qytetarëve. Biografite, telefonat kontaktues dhe adresa elektronike e kryetarit të komunës dhe drejtorit të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve nuk janë në dispozicion të qytetarëve. Koha kur kryetari takon qytetarët është përcaktuar dhe është dita e enjte. Qytetarët e komunës së Leposaviqit nuk janë në gjendje të komunikojnë me drejtorët e ndërmarrjeve apo institucioneve publike sepse nuk ka procedura të qarta për kontakt me ta. Listat e pasurisë së kryetarit dhe drejtorëve të ndërmarrjeve publike/institucioneve janë të publikuara vetëm në ueb faqen e Agjencisë kundër Korrupsionit. Duhet të theksohet se komunikimi në relacionin kuvend dhe kryetar ishte shumë ulët në periudhën e mëparshme, kështu që transparenca e disa punëve komunale ishte e paqartë. Gjatë vëzhgimit të transparencës së komunës së Leposaviqit, pas zgjedhjeve të organizuara në tetor 2017, u formua një shumicë e re qeverisëse dhe u zgjodh kryetari i ri i komunës dhe duket se situata është përmirësuar.

Në lidhje me punën e kuvendit dhe anëtarëve të tij, lista e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Leposaviqit ekziston vetëm në ueb faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndërsa propozimet për shqyrtim në kuvend dhe vendimet e kuvendit shpallen në tabelën e shpalljeve të Komunës për disa ditë me radhë. Qytetarëve u lejohet të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

qytetarët përdorin këtë të drejtë të tyre, por jo në numër aq të madh. Shpalljet për mbajtjen e seancave të Kuvendit, si dhe rendi i ditës, u shpërndahen anëtarëve të Kuvendit në postën e tyre elektronike private dhe publikohen në tabelën e shpalljeve, dhe shpesh herë transmetohen në TV MIR, dhe prandaj mund të supozohet se shumica e qytetarëve janë mirë të njoftuar. Sa i përket transparencës së punës së Kuvendit, RTV MIR i transmeton drejtpërdrejtë të gjitha seancat e kuvendit, prandaj të gjitha vendimet që merren nga kuvendi janë transparente përmes transmetimit të drejtpërdrejtë. Ia vlen të ceket se politika për ndarjen e subvencioneve publikohet në RTV MIR.

Konstatim: Transparenca e punës së kryetarit të komunës dhe kuvendit është në nivel të kënaqshëm, duke iu falënderuar RTV MIR që rregullisht transmeton seancat dhe lajmëron për vendimet që merren nga autoritetet komunale.

Rekomandime: Të përmirësohet transparenca e punës së drejtorëve dhe shërbimeve komunale.

INDEKSI: 3.4 Mirë

BUXHETI

Duke qenë se komuna e Leposaviqit nuk ka ueb faqe zyrtare funksionale, buxheti dhe shpjegimi i tij nuk kanë mundur që të publikohen në të. Sidoqoftë buxheti dhe shpjegimi për atë nuk mund të gjenden në asnjë mjet tjetër informimi. Planet financiare për përfituesit e tërthortë të buxhetit nuk janë publikuar gjëkund. Informatat tremujore për buxhetin nuk mund të gjenden në ndonjë media. Ana pozitive është ajo se thirrja publike për debatin për buxhet transmetohet në media, gjë e cila u mundëson qytetarëve të interesuar pjesëmarrje në diskutim. Diskutimi publik për buxhetin e vitit 2018 është mbajtur dhe është transmetuar drejtpërdrejtë nga televizioni MIR. Projekt buxheti përfundimtar nuk u hedh në diskutim publik deri në përfundimin e këtij raporti. Po ashtu, deklarata për projekt buxhetin nuk është publikuar ose rishikimi i buxhetit nuk u hedh në diskutim publik.

Konstatim: Transparencë e pamjaftueshme në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, posaçërisht në lidhje me përfituesit e tërthortë të buxhetit. Konstatimi është që udhëheqja e re duhet të mbajë dëgjim për propozimet për ta përmirësuar transparencën e zhvillimit të buxhetit të shërbimeve komunale dhe autoriteteve.

Rekomandime: Të ndërmerren hapa për të rritur transparencën e shpenzimeve buxhetore përkitazi me përfituesit e tërthortë, si dhe të përmirësohet ndërgjegjësimi publik për veprimtaritë që kanë të bëjnë me buxhetin.

INDEKSI 2.0 I ulët

QASJA E LIRË NË INFORMACION

Informata për atë se si mund të parashtrohet kërkesa për qasje në informata janë në dispozicion, në bazë të kërkesës, tek sporteli pritës në Komunë. Në vendet e dukshme, nuk ekzistojnë udhëzime për atë se si mund të parashtrohet kërkesa për qasje në informata të rëndësisë publike. Ekziston një pasiguri e dukshme mes qytetarëve për qasjen në informata të rëndësisë publike. Ueb faqja e komunës së Leposaviqit nuk është funksionale dhe prandaj nuk publikohen të dhënat mbi parashtrimin e kërkesave për qasje në informata.

Konstatim: Qasja në informata të rëndësisë publike është e mundshme në bazë të kërkesës. Nuk ekziston ndonjë regjistër për numrin e kërkesave që janë parashtruar për çdo vit.

Rekomandime: Të vendoset një tabelë e dukshme me udhëzimet për atë se si mund të parashtrohet kërkesa për informata të rëndësisë publike. Është i dëshirueshëm edukimi i punonjësve për këtë çështje si dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën e qasjes në informata.

INDEKSI 2.8 I kënaqshëm

PROKURIMI PUBLIK, DONACIONET DHE KONTRATAT

Disa informata për prokurimin publik publikohen në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e komunës, për disa ditë me radhë, si dhe të dhënat për prokurimin publik në 12 muajt e fundit. Burimet që janë përdorur për këtë hulumtim pretendojnë që prokurimi publik nuk zbatohet në përputhje me rregulloret e zbatueshme dhe që procesi i prokurimit publik është tërësisht jotransparent. Në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ku publikohen të gjitha të dhënat për prokurimin publik në Kosovë, të dhënat mund të merren vetëm duke u regjistruar paraprakisht dhe më pas ato janë jo të plota.

Përkundër ekzistimit të udhëzimeve për procedurat e tenderimit, asnjë informatë nuk mund të gjendet në mjetet e informimit për atë se si të përzgjidhet dhe se si të merret vendimi për përbërjen e komisionit vlerësues. Informata për fituesin e tenderit publikohet në tabelën e shpalljeve dhe kontratat me fituesit i vihen në dispozicion qytetarëve vetëm në bazë të kërkesës për qasje në dokument publike. Komuna e Leposaviqit nuk i financon mediat për shkak të kufizimeve në buxhet.

Konstatim: Transparenca e procedurave të tenderimit është shumë e ulët, përkundër ekzistimit të udhëzimeve. Donacionet jotransparente ashtu si kontratat që nënshkruhen nga komuna me palët e treta.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Rekomandime: Në mungesë të një ueb faqeje komunale funksionale, të përdoren mediat për të shpallur metodën e përzgjedhjes së komisionit për vlerësimin e dokumenteve të tenderit, si dhe në përgjithësi të përdoren mediat për të informuar qytetarët për prokurimin publik, donacionet dhe kontratat.

INDEKSI 2.0 I ulët

NDËRMARRJET PUBLIKE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE

Janë përcaktuar kriteret për përzgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe të drejtorëve të drejtorive, por dokumentet që kanë të bëjnë me procedurat e përzgjedhjes së drejtorit dhe shefit të drejtorisë nuk janë të publikuar gjëkund, vetëm lajmërimi për vendimet shpallet në tabelën e shpalljeve. Ndërmarrjet publike në komunën e Leposaviqit nuk kanë ueb faqet e tyre, prandaj edhe nuk publikohen planet vjetore e as raportet për punën e tyre. Informata e tillë është në dispozicion vetëm në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike. Lista e çmimeve të shërbimeve që ofrohen nga ndërmarrjet publike është e publikuar në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjeve.

Nuk janë publikuar sistematizimi i ndërmarrjeve publike si dhe sistematizimi i vendeve të punës dhe numrit të punëtorëve, por janë në dispozicion në bazë të kërkesës së parashtruar për qasje në dokumente publike. Shpalljet për vendet e lira të punës u vendosën në tabelën e shpalljeve dhe u transmetuan në RTV MIR, por nuk dihet se cilat janë kriteret për përzgjedhjen e komisionit për vendet e lira të punës.

Konstatim: Transparencë e pamjaftueshme në përzgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Rekomandime: Të publikohen dokumentet përkitazi me procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve në tabelën e shpalljeve dhe në media. Sistematizimi i ndërmarrjeve publike dhe i vendeve të punës duhet të shpallet në tabelën e shpalljeve të kuvendit të komunës ose në ndonjë vend të dukshëm, si dhe në ndërtesën e kuvendit deri në funksionalizimin e ueb faqes zyrtare së komunës.

INDEKSI 2.4 Neutral

RAPORTET ME SHOQËRINË CIVILE

Sipas fjalëve të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, komuna e Leposaviqit ka raporte mjaft të mira me ta. Megjithatë, memorandumet e bashkëpunimit të nënshkruara me OJQ-të nuk janë publikuar akoma në ndonjë media, por në bazë të kërkesës për qasje në informata ato vihen në dispozicion për këqyrje.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Takimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile me autoritetet lokale, kryesisht me kryetarin e komunës dhe anëtarët e kuvendit të komunës, mbahen sipas nevojës dhe nuk merr shumë kohë për ta caktuar një takim të tillë. Megjithatë, në kohën e shkrimit të këtij raporti, komuna e Leposaviqit nuk i ka financuar veprimtaritë e shoqërisë civile për shkak të mungesës së financimit për sektorin e OJQ-ve. Në rastet kur komuna ka ndonjë projekt të përbashkët me ndonjë organizatë të shoqërisë civile, meqenëse ueb faqja e komunës së Leposaviqit nuk është funksionale, të gjitha informatat në lidhje me zbatimin e projektit mund të gjenden në tabelën e shpalljeve, në ueb faqen apo faqet e rrjeteve sociale të këtyre OJQ-ve apo transmetohen nga RTV MIR. Në lidhje me seancat e kuvendit të komunës së Leposaviqit, anëtarët e disa OJQ-ve i ndjekin seancat e kuvendit.

Konstatim: Duke pasur parasysh se komuna e Leposaviqit nuk ka mjete financiare për të përkrahur organizatat e shoqërisë civile, është shumë i kënaqshëm raporti që ka në kuptim të ofrimit të çfarëdo përkrahjeje tjetër dhe transparencës. Ka hapësirë për përmirësimin e punës me organizatat e shoqërisë civile.

Rekomandime: Pas çdo memorandumit të mirëkuptimit apo letrave përkrahëse, t'i drejtohen mediave me to deri në publikimin në ueb faqe dhe më pas të gjitha informatat të publikohen në ueb faqe.

INDEKSI 3.6 Mirë

PLANIFIKIMI URBAN

Duke qenë se komuna e Leposaviqit nuk ka një ueb faqe zyrtare funksionale, nuk ka ekzistuar mundësia e shqyrtimit në mënyrë elektronike. Komuna e Leposaviqit po ashtu nuk ka hartë elektronike interaktive. Planet hapësinore dhe planet urbane nuk janë publikuar në ndonjë media. Lista e lejeve të ndërtimit që janë lëshuar nuk është shpallur në mënyrë publike, si dhe nuk janë shpallur vendimet dhe shpjegimet për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Certifikatat e lejeve të ndërtimit që janë lëshuar në përputhje me planin urban janë në dispozicion, në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Konstatim: Shkallë shumë e ulët e transparencës.

Rekomandime: Planet hapësinore dhe planet urbane të publikohen në media dhe qytetarët të njoftohen për mënyrat se si të qasen në ato. Të publikohet lista e lejeve për ndërtim që janë lëshuar si dokument publik.

INDEKSI 2 I ulët

PRONA KOMUNALE

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Komuna e Leposaviqit nuk ka regjistër publik të pronës së paluajtshme komunale për shkak se, si na u shpjegua, komunat janë të themeluara rishtazi dhe nuk kanë ndonjë pronë në posedim të tyre. Këto pretendime po sfidohen nga organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, të cilat pretendojnë se komuna ka në pronësi ndërtesën, automjetin dhe se është themeluese e disa ndërmarrjeve. Nuk ekziston hartë interaktive me informata për pronën komunale si dhe nuk ka informata për shfrytëzimin e pronës komunale. Sipas burimeve të ndryshme të informacionit, prona komunale nuk është privatizuar dhe prandaj nuk ka informata të natyrës publike për atë.

Lista e inventarit përgatitet në fund të çdo viti dhe publikohet në tabelën e shpalljeve për disa ditë me radhë. Përveç kësaj, lista e inventarit vihet në dispozicion për shqyrtim në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike. Komuna e Leposaviqit nuk ka aksione në ndonjë ndërmarrje tjetër. Lista e automjeteve dhe vlera e tyre nuk është në dispozicion për qytetarët dhe as nuk është publikuar në media.

Konstatim: Prona komunale nuk është e përkufizuar në mënyrë të qartë dhe mungesa e hartës interaktive me pronën komunale ngre disa pikëpyetje.

Rekomandime: Të krijohet harta interaktive apo një regjistër publik i pronës komunale, sa më shpejt që është e mundshme dhe të publikohet në media. Të publikohet lista e automjeteve në pronësi komunale dhe vlera e tyre. Pas krijimit të ueb faqes, të bëhen transparente të gjitha informatat.

INDEKSI 2.5 Neutral

ZVEÇAN

Raport për Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale



KOMUNA, KUVENDI I KOMUNËS, DREJTORËT

Komuna e Zveçanit e ka ueb faqe zyrtare që megjithatë nuk është funksionale dhe si pasojë shumë informata nuk janë në dispozicion për qytetarët. Prandaj biografitë dhe informatat e kontaktit (numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike) të kryetarit dhe drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve nuk mund të gjenden në ndonjë mjet informimi. Orari kur kryetari takon qytetarët nuk është i përcaktuar shprehimisht, zakonisht kjo ndodh çdo të premte por në bazë të një inspektimi në terren ne e zbuluam se kjo nuk ndodh çdo të premte. Qytetarët e Zveçanit nuk janë në gjendje të komunikojnë me drejtorët e ndërmarrjeve publike ose institucioneve. Ndërmarrjet dhe institucionet që ekzistojnë në komunën e Zveçanit punojnë ose sipas sistemit të Serbisë, ose janë në proces të integritimit. Lista e pasurisë së kryetarit dhe drejtorëve të ndërmarrjeve publike/institucioneve janë të publikuara vetëm në ueb faqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Ekziston një ueb faqe funksionale që quhet E-Komuna Zveçan, e cila mund të gjendet në <http://www.eopstinazvecan.com/>, por për shkak se kjo faqe është nën administrimin e një

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

organizate të shoqërisë civile, çështja është nëse kjo është mënyra më e parapëlqyer për publikimin zyrtar të informatave për autoritet lokale që janë zgjedhur ligjërisht?

Në lidhje me punën e kuvendit dhe anëtarëve të tij, lista e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Zveçanit ekziston vetëm në ueb faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndërsa propozimet për shqyrtim në kuvend dhe vendimet e kuvendit shpallen në tabelën e shpalljeve të Komunës për disa ditë me radhë. Ndonëse qytetarëve u mundësohet pjesëmarrja në seancat e Kuvendit, numri i atyre që marrin pjesë është shumë i vogël për shkak të shpërfilljes së kësaj të drejte, si pasojë e mungesës së ndërgjegjësimit. Domethënë, lajmërimet për mbajtjen e seancës së Kuvendit si dhe rendi i ditës u dërgohen anëtarëve në postën e tyre elektronike private dhe publikohen në tabelën e shpalljeve, prandaj vështirë apo asnjëherë nuk arrijnë tek qytetarët të cilët jetojnë në zonat rurale. Nëse publikohen në media, atëherë kjo ndodh pikërisht në ditën e seancës.

Konstatim: Transparenca e bartësve të funksioneve në komunën e Zveçanit është në nivel të pranueshëm, ashtu si edhe transparenca e punës së drejtorëve të komunës dhe anëtarëve të kuvendit. Komunikimi me autoritetet qeveritare është i mundshëm. Metoda e shpalljeve është shumë pak e dukshme.

Rekomandime: Të publikohen mënyrat për vënien e kontaktit me kryetarin, drejtorët dhe anëtarët e kuvendit. Rekomandohet paraqitja më e shpeshtë në media dhe dhënia e informatave përmes paraqitjeve në media. Këshillohet dhënia e informatave me kohë përmes mediave për mbledhjet e kuvendit, me qëllim që qytetarët të mund të marrin pjesë në ato mbledhje.

INDEKSI 2.8 I kënaqshëm

BUXHETI

Propozimi për projekt buxhetin përfundimtar për vitin e kaluar u paraqit si pikë e rendit të ditës në seancën e kuvendit, pas së cilës u mbajt dëgjimi publik për buxhetin e vitin 2018, në prani të disa organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve të interesuar. Rishikimi i buxhetit po ashtu u propozua si pikë e rendit të ditës në seancën e KK të Zveçanit, por nuk ka pasur shumë debat për shkak të pjesëmarrjes së ulët të qytetarëve, ndonëse njoftimi për atë ishte publik dhe i dërguar me kohë. Për shkak të mosfunksionimit të ueb faqes zyrtare të komunës së Zveçanit, buxheti, planet financiare të përfituesve të tërthortë, informatat për zbatimin tremujor të buxhetit, njoftimet për diskutim publik për buxhetin dhe informatat e ngjashme në lidhje me buxhetin e komunës së Zveçanit, janë të publikuara vetëm në tabelën e shpalljeve të komunës për disa ditë me radhë.

Konstatim: Si një tregues shumë i përhapur, shkalla e transparencës është shumë e ulët përkundër asaj që është marrë në konsideratë edhe mungesa e ueb faqes së komunës. Vlerësohet si pozitive informimi i organizatave të shoqërisë civile për seancat për buxhetin.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Rekomandime: Të publikohen në media planet financiare të përfituesve të tërthortë dhe informatat për zbatimin tremujor të buxhetit. Të nisët një fushatë për shtimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në diskutimet për buxhet. Të arkivohen të dhënat në mënyrë që të ngarkohen menjëherë në faqe pasi që të jetë krijuar ajo.

INDEKSI: 2.8 I kënaqshëm

QASJA E LIRË NË INFORMACION

Nuk ekzistojnë shpjegime a udhëzime për atë se si mund të parashtrahet kërkesa për qasje në informata të rëndësishme publike. Informatat për parashtrimin e kërkesës për qasje në dokumentet publike janë në dispozicion në sportelin pritës në komunë. Përmes një inspektimi, përshtypja që u fitua ishte se vetë punonjësit në sportelin pritës të komunës nuk kanë njohuri të mjaftueshme për procedurën dhe të drejtën e qytetarëve për qasje në informata. Ueb faqja e komunës së Zveçanit nuk është në funksion dhe prandaj nuk publikohen të dhënat mbi parashtrimin e kërkesave për qasje në informata.

Konstatim: Qasja në dokumente publike është e mundshme, por ajo çka vërehet është mungesa e njohurisë së personelit për të trajtuar kërkesat për qasje të lirë në informacion. Ekziston mundësia e sigurimit të informatave të rëndësishme publike në bazë të kërkesës, bashkë me një shpjegim paraprak.

Rekomandime: Të arsimohet personeli për të drejtën e qytetarëve për qasjen në dokumente publike si dhe të krijohen procedurat për këtë gjë.

INDEKSI: 2.6 I kënaqshëm

PROKURIMI PUBLIK, DONACIONET DHE KONTRATAT

Për shkak të mosfunksionimit të ueb faqes zyrtare të komunës, informatat për prokurimin publik publikohen në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e komunës për disa ditë me radhë. E njëjta gjë vlen për të dhënat për prokurimin publik për 12 muajt e fundit. Burimet që janë përdorur për këtë hulumtim pretendojnë që prokurimi publik zbatohet në përputhje me rregulloret e zbatueshme.

Në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ku publikohen të gjitha të dhënat për prokurimin publik në Kosovë, të dhënat mund të merren vetëm duke u regjistruar paraprakisht dhe më pas ato janë të pakompletuara dhe gjysmake.

Ndonëse ekziston një udhëzim për procedurat e tenderimit dhe parimet etike për vetë procedurën, asnjë informatë nuk mund të gjendet në ndonjë mjet informimi për atë se si përzgjidhet dhe se si merret vendimi për përbërjen e komisionit vlerësues. Informata për fituesin e tenderit publikohet

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

në tabelën e shpalljeve dhe kontratat me fituesit i vihen në dispozicion qytetarëve vetëm në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Sipas zyrtarëve të komunës së Zveçanit, ekziston një program ku bëhet shpallja e thirrjes për dhënien me qira të pronësi të komunës, por nuk ceket se për çfarë programi bëhet fjalë. Gjithashtu, nuk është publikuar ndonjë raport për dhënien a lëshimin me qira. Në lidhje me financimin e mediave, komuna e Zveçanit nuk i financon mediat për shkak të kufizimeve në buxhet.

Konstatim: Transparenca e procedurave të tenderimit është shumë e ulët, përkundër ekzistimit të udhëzimeve. Donacionet jotransparente ashtu si kontratat që nënshkruhen nga komuna me palët e treta. Vlerësohet si pozitive shpallja e fituesve të tenderit në tabelën e shpalljeve.

Rekomandime: Në mungesë të një ueb faqeje komunale funksionale, të përdoren mediat për të shpallur metodën e përzgjedhjes së komisionit për vlerësimin e dokumenteve të tenderit, si dhe në përgjithësi të përdoren mediat për të informuar qytetarët për prokurimin publik, donacionet dhe kontratat.

INDEKSI 2.5 Neutral

NDËRMARRJET PUBLIKE DHE ADMINISTRATA PUBLIKE

Ekzistojnë kriteret për përzgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe shefit të drejtorisë, por dokumentet në lidhje me procedurat e përzgjedhjes së drejtorit dhe shefit të drejtorisë janë të publikuara vetëm në tabelën e shpalljeve, për shkak se nuk ka ueb faqe. Ndërmarrjet publike në komunën e Zveçanit nuk kanë ueb faqet e tyre, prandaj edhe nuk publikohen planet vjetore të punës e as raportet për punën e tyre. Informata e tillë është në dispozicion vetëm në bazë të kërkesës për qasje në dokumente publike, ndërsa lista e çmimeve për përdorimin e ndërmarrjeve publike publikohet në tabelën e shpalljeve të vetë ndërmarrjeve.

Nuk janë publikuar sistematizimi i ndërmarrjeve publike si dhe sistematizimi i vendeve të punës dhe numrit të punëtorëve, por janë në dispozicion në bazë të kërkesës së parashtruar për qasje në dokumente publike. Shpalljet për vende të lira të punës publikohen në tabelën e shpalljeve dhe në mediat lokale (TV Most, Kontakt Plus Radio, Radio Mitrovica, KosSev, etj.).

Konstatim: Transparencë e kënaqshme e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe shefave të drejtorive, duke pasur parasysh kushtet dhe mungesën e ueb faqes zyrtare të komunës.

Rekomandime: Të përdoret tabela e shpalljeve për të publikuar numrin e punonjësve në komunë dhe shërbimet komunale, si dhe sistematizimin e vendeve të punës deri në krijimin përfundimtar të ueb faqes së komunës.

INDEKSI 2.6 I kënaqshëm

RAPORTET ME SHOQËRINË CIVILE

Komuna e Zveçanit ka nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me OJQ gjegjëse, memorandume këto që nuk janë të publikuara në ndonjë mjet informimi, por që janë në dispozicion në bazë të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare. Takimet me përfaqësuesit e shoqërisë civile mbahen sipas nevojës. Sidoqoftë, komuna e Zveçanit nuk ka fonde të mjaftueshme për të financuar sektorin e OJQ-ve përveç nëse komuna dhe OJQ-të zbatojnë ndonjë projekt të përbashkët. Në këtë rast, duke qenë se ueb faqja zyrtare e komunës së Zveçanit nuk është në funksion, të gjitha informatat që kanë të bëjnë me zbatimin e projekteve mund të gjenden në ueb faqen jozyrtare të komunës në Facebook, ueb faqet apo faqet e rrjeteve sociale të këtyre OJQ-ve si dhe në ueb faqet e mediave elektronike (KoSSev, Radio Mitrovica Sever, etj.). Në lidhje me seancat e kuvendit të komunës të Zveçanit, anëtarët e disa OJQ-ve rregullisht i monitorojnë seancat e kuvendit.

Konstatim: Transparencë e kënaqshme e raporteve me shoqërinë civile duke pasur parasysh rrethanat.

Rekomandimet: Të vazhdohet puna transparente për fuqizimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimi transparent me sektorin joqeveritar. Të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjitha organizatat e shoqërisë civile, pa favorizuar personat e caktuar.

INDEKSI 3.2 Mirë

PLANIFIKIMI URBAN

Duke qenë se ueb faqja e komunës së Zveçanit nuk është në funksion, të gjitha informatat në lidhje me urbanizmin - planet hapësinore, planet urbane, lista e lejeve për ndërtim që janë lëshuar, vendimet dhe shpjegimet për lëshimin e lejeve për ndërtim, pra nëse lejet e ndërtimit që janë lëshuar janë në përputhje me planin urban, etj., - janë në dispozicion në bazë të kërkesës për qasje në dokumentet zyrtare dhe në disa raste ato publikohen për një periudhë të shkurtër kohore në tabelën e shpalljeve në komunë. Vlen të theksohet se është shumë lehtë për të marrë informata nga drejtoria e urbanizmit.

Sipas zyrtarëve të komunës, harta interaktive e komunës së Zveçanit është në zhvillim e sipër si dhe komuna ka plan për mbrojtjen e mjedisit, i cili megjithatë, nuk është i publikuar gjëkund. Sipas burimeve nga sektori joqeveritar, procedura e përzgjedhjes për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Mjedisin nuk ka qenë transparente.

Konstatim: Shkallë mjaft e ulët e transparencës përkitazi me publikimin e planeve urbane dhe metodën e vendimmarrjes për lëshimin e lejeve për ndërtim.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale

Rekomandime: Të lehtësohen procedurat për të pasur qasje në planet urbane dhe të publikohet plani për mbrojtjen e mjedisit në media sociale.

INDEKSI 2.8 I kënaqshëm

PRONA KOMUNALE

Zyrtarët e komunës pretendojnë se ‘nuk ekziston regjistri publik i pronës së paluajtshme sepse komuna e Zveçanit, e cila funksionon sipas ligjeve dhe sistemit të Kosovës, është themeluar rishtazi dhe nuk ka ndonjë pronë në posedim të saj’. Prandaj nuk ekziston hartë interaktive me të dhëna për pronën komunale si dhe nuk ka informata për shfrytëzimin e pronës komunale. Nga një inspektim i thjeshtë u zbulua se Banka MTS funksionon në hapësirat e kuvendit të komunës!

Sipas shumicës së burimeve, nuk ka ndodhur që prona komunale të privatizohet edhe në të kaluarën.

Në fund të çdo viti, përpilohet listë e inventarit që publikohet në tabelën e shpalljeve për disa ditë më radhë. Përveç kësaj, lista e inventarit është në dispozicion për shqyrtim në bazë të kërkesës për qasje në informata të rëndësisë publike. Komuna e Zveçanit nuk ka aksione në ndonjë ndërmarrje tjetër.

Listat e automjeteve në pronësi të komunës dhe vlera e tyre nuk është e publikuar gjëkund.

Konstatim: Përshtypja është se prona komunale nuk është e përkufizuar në mënyrë të qartë dhe se mungesa e hartës interaktive me pronën komunale ngre disa pikëpyetje.

Rekomandime: Të krijohet harta interaktive apo një regjistër publik i pronës komunale dhe të publikohet. Të përpilohet një listë me automjetet në pronësi të komunës së bashku me vlerën e tyre dhe të publikohet ajo.

INDEKSI 2.2 Neutral